Mora në dorëzim
DT 25/04/08
Aldenis Cupthej



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**KESHILLI KOMBETARE I UJIT**
**KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES DRIN – BUNE**

Adresa: Qendra Transferimit te Teknologjive Bujqesore.Kati 3-te,Cel.0682081245

**Nr.** 334. **Prot.** **Shkoder,dt.** 21.04. **2008**

# INFORMACION

## "MBI PERDORIMIN E BURIMIT UJOR PERROI I RADOMIRES ( ELBTHIT) DHE BJESHKA E SHEHUT FSHATI RADOMIRE H/C RADOMIRE PER PRODHIM TE ENERGJISE ELEKTRIKE NGA SUBJEKTI " ASJA ALBANIA"

Bazuar ne kerkesen e pa kerkuar te bere nga subjekti " ASJA ALBANIA "per perdorim te burimit ujor Perroi i Radomires (Elbthit) dhe Bjeshka e Shehut per prodhim energjie elektrike nen 15 MW, dhe se propozimi i mesiperm, sipas dokumentacionit qe disponon K.B.U. Drin-Bune, nuk ka te beje me projekte, per te cilat ka filluar apo eshte shpallur procedura e perzgjedhjes.

Sipas dokumentacionit te paraqitur nga subjekti i mesiperm, vepra e marrjes se ujit ne Perroin e Radomires (Elbthit) do te ndertohet ne kuoten 1652 m mbi nivelin e detit, ndersa ne Perroin Bjeshka e Shehut ne kuoten 1652 m mbi nivelin e detit. Ne aksin e vepres marrjes ne Perroin e Radomires (Elbthit) prurja mesatare eshte Q= 0.34 m3/sek., ndersa ne Perroin Bjeshka e Shehut prurja mesatare eshte Q= 0.25 m3 / sek.Subjekti kerkon te shfrytezoje nje prurje Q= 0.9 m3/sek.

Subjekti gjate periudhes se veres nuk do pengoje vaditjen.

Ky informacion jepet nga K.B.U. Drin-Bune Shkoder, bazuar ne nenet 4, 5, 9 dhe 23 te ligjit nr. 9663 dt. 18.12.2006 "PER KONCESIONET ", dhe ne zbatim te tij te germes b, pika 3, kreu IV, i V.K.M.-se nr. 87, dt. 16.01.2008, "Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr. 27 dt. 19.01.2007, te K.M., "Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe dhenies se koncesioneve", te ndryshuar, per plotesim dokumentacioni.

**PER KESHILLIN E BASENIT UJEMBLEDHES**
**DRIN-BUNE**

**SEKRETARI**
**Ing. Osman DELTINA**

**KRYETARI**
**Maxhid CUNGU**

REPUBLIKA E SHQIPERISE KESHILLI KOMBETAR I UJIT KESHILLI I BASENIT DRIN-BUNE